



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 765/3 prot.

Tiranë, më 26. 07. 2021

V E N D I M

Nr. 136, datë 26. 07. 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma b), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 92, datë 18.05.2021, të H. T., përfaqësuar¹ nga Organizata “Për Drejtësi Sociale”, ku pretendohet diskriminim për shkak të *etnisë dhe gjendjes ekonomike*, nga ana e Bashkisë Durrës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Organizata “Për Drejtësi Sociale” ka sqaruar se: “H. T. është banor në qytetin e Durrësit dhe familja e tij përbëhet nga 4 anëtarë, pjesë të komunitetit rom. Në datë 26.06.2020, H. T. ka aplikuar pranë Bashkisë Durrës, për përfitim të pagesës së qirasë, si një ndër familjet e prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, ku banesa e tij është shpallur e pabanueshme. Deri më sot, nuk është trajtuar ky aplikim, duke e përjashtuar nga mundësia për të përfitur ndihmën e përcaktuar pikërisht për rastet e tërmetit. Në kuadrin ligjor, ne e shohim se mostrajtimi i aplikimit për të përfitur pagesën e qirasë ndaj H. T. është diskriminues, pasi banorë të tjerë aty afër zonës ku dhe ai banon, si z. N. Z. etj, pjesë e maxhorancës, janë trajtuar nga ana e Bashkisë Durrës.”

Në përfundim të ankesës së sipërcituar, Organizata “Për Drejtësi Sociale”, pretendon se H. T. është diskriminuar nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Durrës, për shkak të *etnisë dhe gjendjes ekonomike*, duke mos e trajtuar me bonus qiraje, si familje e cila është prekur nga tërmeti i muajit nëntor 2019.

¹ Me autorizim lëshuar G. S.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/b të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të LMD-së, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 765/1 prot, datë 01.06.2021, nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion Bashkisë Durrës, si palë kundër së cilës është paraqitur ankesa, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Në përgjigje të shkresës së KMD-së, Bashkia Durrës, me shkresën⁴ Nr. 6630/1, datë 10.06.2021 informoi se: “...Këshilli Bashkiak Durrës ka miratuar me VKB nr. 92, dt. 30.09.2020 ‘Për miratimin e listës së familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë të mbetura të pastreha si pasojë e shembjes së banesave të tyre në zbatim të VKB-së nr. 18, datë 23.04.2020, VKB-së nr. 37, datë 14.05.2020, VKB-së nr.52, datë 25.06.2020 dhe VKB-së nr. 54, datë 25.06.2020, VKB-së nr. 65, datë 07.07.2020, VKB-së nr. 66, datë 14.07.2020, VKB-së nr. 85, datë 31.08.2020, për

³Shkurtesë për ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 765/2 prot., datë 14.06.2021

familjen e L. T. është miratuar subvencionimi i qirasë me nr. rendor 130. Ashtu siç ju kemi vënë në dijeni dhe në e-maillet e mëparshme në lidhje me bonusin e qirasë të familjes së L. T., ju sqarojmë se në bazë të Prokurës së Posaçme të datës 06.02.2020 L. T. i ka dhënë të drejtën H. T. për të kryer të gjitha procedurat për marrjen e bonusit të qirasë, prandaj Bashkia Durrës i bën likuidimin e bonusit të qirasë në nr. llog. të H. T.

Në lidhje me aplikim e H. T. ju informojmë se kjo familje nuk është përfituese për bonus qiraje pasi dokumentacioni i dërzuar nga qytetari është jo i saktë (p.sh. vërtetimi i sjellë nga qytetari është i njëjti vërtetim me L. T. duke fshirë emrin e saj dhe duke vendosur emrin e tij. Qytetari ka sjellë dokumentacionin në emer të tij, por akt konstatimi është pallati i L. T., ndërkohë që qytetari ka deklaruar se jeton në banesë individuale. (Shtojca A3)...”.

Bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje, Bashkia Durrës ka vënë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, një kopje të aplikimit të ankuesit për subvencionimin e qerasë.

2. Nëpërmjet e-mailit datë 15.06.2021, Komisioneri i ka vënë në dispozicion të Organizatës “Për Drejtësi Sociale”, një kopje të përgjigjes së Bashkisë Durrës, si dhe bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar, Organizata “Për Drejtësi Sociale”, me e-mailin datë 15.06.2021, sqaroi Komisionerin ndër të tjera se: “...Në muajin shkurt 2020 H. T. ka bërë aplikimin pranë Bashkisë Durrës për të përfituar bonusin e qirasë, por pas disa muajsh kur ka shkuar për të marrë informacion tek Bashkia, është informuar se institucioni e ka humbur aplikimin e H. T. E njëjta situatë ka ndodhur dhe me aplikimin e dytë në muajin qershor, sërish ka humbur aplikimi. Më pas rasti është bërë mediatik nga H. T. Menjëherë pas publikimit në media, H. T. është thirrur nga Kryetari Njësisë Administrative Sukth për të firmosur dy shkresa, pasi sipas kryetarit ishin për përfitimin e bonusit. Por edhe pas kësaj H. T. nuk e ka përfituar bonusin. Në lidhje me aplikimin dhe përfitimin e nënës së H. T., po, është e vërtetë që ka përfituar. Nëpërmjet prokurës së përfaqësimit djali i saj ka përmbyllur aplikimin dhe ka bërë tërheqjen e pagesës, pasi pas tërmetit ka shkuar në Greqi.

Por, iu bëjmë me dije referuar dhe formularit të aplikimit dhe akt-ekspertizës bëhet fjalë për dy banesa të ndryshme. Pasi akt-ekspertiza bën fjalë për ndërtesën (pallat 5 kate) e L. T., ndërsa formulari aplikimit për banesën (proces legalizimi) e H. T.”

3. Nëpërmjet e-mailit datë 22.06.2021, Komisioneri ka kërkuar nga Organizata “Për Drejtësi Sociale”, kopje të shkresave të shkëmbyera ndërmjet tyre dhe Bashkisë Durrës, sa i përket aplikimit të H. T. të përgjigjes së Bashkisë Durrës, si dhe bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar, Organizata “Për Drejtësi Sociale”, me e-mailin datë 28.06.2021, sqaroi Komisionerin ndër të tjera se: “...vërtetohet se aplikimi është bërë me dy banesa të ndryshme, H. T. për banesën e tij godinë 1 katëshe në proces legalizimi si dhe L. T. për

banesën e saj godinë 5 katëshe (pallat) kati i parë. Kjo e vërtetuar dhe tek akt konstatimet e grupit të ekspertëve...”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimet e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar⁵, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Për shkak të fatkeqësisë natyrore si shkak i tërmetit që preku Shqipërinë më datë 26 Nëntor 2019, Këshilli i Ministrave miratoi Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 *“Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore”*, i cili në Nenin 26 të tij ka parashikuar se:

“1. Familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, të mbetura të pastreha pasi banesat ose shtëpitë e banimit individuale të tyre janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm, përfitojnë një

⁵ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*

pagesë qiraje në vlerën mesatare të tregut të lirë, për një vit, që miratohet me vendim të organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore.

2. Për përfitimin e pagesës së qirasë, subjektet përfituese aplikojnë pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin, duke dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Formularin e aplikimit sipas formati të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

b) Aktkonstatimin e Institutit të Ndërtimit;

c) Certifikatën familjare;

ç) Numrin e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e përshpejtuara për shqyrtimin e aplikimeve dhe miratimin përkatës të subjekteve përfituese dhe të nivelit të qirasë me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

4. PAGESA E QIRASË, PAS KALIMIT TË AFATIT TË PARASHIKUAR NË PIKËN 1, TË KËTJË NENI, MUND TË MIRATOHET DERI NË PËRFITIMIN E BANESËS SË RE NGA AUTORITETET PËRGJEGJËSE SHTETËRORE OSE DERI NË PËRFUNDIMIN E NDËRTIMIT APO TË RIKONSTRUKSIONIT TË BANESËS, NË ZBATIM TË PROGRAMEVE TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË PARASHIKUARA NË KËTË LIGJ, NËSE PËRFITUESI PLOTËSON KRITERET DHE DOKUMENTACIONIN PËRKATËS, SIPAS PARASHIKIMEVE TË LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR STREHIMIN SOCIAL...”.

Pra, kategoritë që mund të përfitojnë pagesë qiraje, janë edhe familjet e prekura nga fatkeqësitë natyrore, siç ishte edhe tëmeti i datës 26 Nëntor 2019. Për përfitimin e pagesës së qirasë, subjektet përfituese duhet të paraqesin aplikimin e tyre pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore, duke dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

a) Formularin e aplikimit sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

b) Aktkonstatimin e Institutit të Ndërtimit;

c) Certifikatën familjare;

ç) Numrin e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë.

Për sa më lart, bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë KMD-së, nga ankuesi, rezultojnë që H. T. është paraqitur pranë Njësisë Administrative Sukth, në të cilën ka edhe vendbanimin. Në vijim, ankuesi ka depozituar më datë 12.12.2019, pranë Njësisë Administrative Sukth 2 (dy) aplikime për përfitimin e pagesës së qirasë, një për L. T. (të ëmën) dhe një për familjen e tij.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga palët, rezultojnë se ankuesi për aplikimin e tij, ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular i Strehimit “Për përfitimin e pagesës së qirasë nga familjet që janë evakuuar nga banesat e tyre, për shkak se janë shpallur të pabanueshme, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”, datë 26.06.2020;
- Kartë Identiteti e H. T.;
- Certifikatë Familjare të H. T.;
- Vërtetim në emër të H. T., lëshuar nga Njësia Administrative Sukth, datë 12.12.2019, me anë të të cilit është vlerësuar si banesë e pabanueshme;

- Akt Konstatimi datë 02.12.2019, lëshuar nga Instituti i Ndërtimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Shtojca C, Vërtetim që konfirmon regjistrimin e kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura;
- Shtojca A 3, Formular aplikimi për të përfituar nga programi i formularëve të rindërtimit.
- Akt-Ekspertizë e Thelluar;
- Nr. i llogarisë së H. T.

Gjithashtu, palët kanë vënë në dispozicion të Komisionerit një kopje të aplikimit të ankuesit, në emër të L. T. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se H. T. ka dorëzuar në të njëjtën ditë, pranë strukturave të Njësisë Vendore, dokumentacionin në emër të L. T., si më poshtë vijon:

- Formular i Strehimit “*Për përfitimin e pagës së qirasë nga familjet që janë evakuuar nga banesat e tyre, për shkak se janë shpallur të pabanueshme, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019*”, datë 26.06.2020;
- Vërtetim në emër të L. T., lëshuar nga Njësia Administrative Sukth, datë 12.12.2019, me anë të të cilit është vlerësuar si banesë e pabanueshme;
- Prokurë e Posaçme Nr. rregj. 2597179, me anë të së cilës H. T. përfaqëson L. T. për ndjekjen e procedurave pranë Bashkisë Durrës;
- Certifikatë Familjare të L. T.;
- Kartë Identiteti e H. T.;
- Akt Konstatimi datë 02.12.2019, lëshuar nga Instituti i Ndërtimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Kontratë Shitblerje e banesës së L. T.;
- Shtojca C, Vërtetim që konfirmon regjistrimin e kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura;
- Nr. i llogarisë së H. T.

Përsa më sipër dhe në analizë të dokumentacionit të administruar, rezulton se L. T., ka banuar në një pallat 5 (pesë) katësh, me adresë Kullë-Sukth, ndërsa ankuesi në banesë 1-katëshe në proces legalizimi.

Referuar aplikimeve të sipërcituara, Këshilli Bashkiak Durrës me VKB-në nr. 92, datë 30.09.2020 “*Për miratimin e listës së familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë të mbetura të pastreha si pasojë e shembjes së banesave të tyre*”, në zbatim të VKB-së nr. 18, datë 23.04.2020, VKB-së nr. 37, datë 14.05.2020, VKB-së nr. 52, datë 25.06.2020 dhe VKB-së nr. 54, datë 25.06.2020, VKB-së nr. 65, datë 07.07.2020, VKB-së nr. 66, datë 14.07.2020, VKB-së nr. 85, datë 31.08.2020, për familjen e L. T. ka miratuar subvencionimin e qirasë me nr. rendor 130. Në zbatim të vendimarrjes së Këshillit Bashkiak, Bashkia Durrës ka vijuar procedurat për likuidimin e bonusit të qirasë në numrin llogarisë së H. T.

Në lidhje me aplikimin e H. T., Këshilli Bashkiak Durrës, nuk e ka miratuar familjen e H. T., si përfituese për shkak të pasaktësive në dokumentacionin e dorëzuar gjatë aplikimit të tij.

Nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se ankuesi gjatë aplikimit të bërë për përfitimin e qirasë, në ndryshim nga aplikimi i bërë në emër të L. T., ka dorëzuar Formularin e Aplikimit, Shtojca A 3, për të përfituar nga programi i formularëve të rindërtimit, në të cilin evidentohet se në rubrikën “*Dokumentacion mbi pronësinë*”, citohet “*Vetëdeklarim për legalizim (formular vetëdeklarim ose vërtetim ASHK)*”.

Gjithashtu, në ndryshim nga aplikimi në emër të L. T., në Formularin e Strehimit “*Për përfitimin e pagesës së qirasë nga familjet që janë evakuuar nga banesat e tyre, për shkak se janë shpallur të pabanueshme, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019*”, të dorëzuar më datë 26.06.2020, rezulton se në rubrikën “*Të dhëna mbi banesën në pronësi, të dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019*”, ka specifikuar se banesa në pronësi të tij është “*banesë 1-katëshe, 60 m²*”.

Ndërkaq, rezulton se ankuesi në dokumentacionin e depozituar për përfitimin e pagesës së qirasë, ka dorëzuar të njëjtin Akt-Konstatim të mbajtur gjatë verifikimit në terren të pallatit në të cilin banonte L. T., dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019. Akt-Konstatimi mban Nr. 13, datë 02.12.2019 dhe është lëshuar nga Grupi i Inspektimit të Institutit të Ndërtimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjithashtu, pjesë e dokumentacionit të depozituar nga ankuesi, në Bashkinë Durrës, është edhe Akt-Ekspertiza e Thelluar “*Për përcaktimin e masave që nevojiten të merren për objektet ndërtimore të listuara si të pabanuara pas tërmetit të datës 26.11.2019*”. Nga analizimi i këtij dokumenti rezulton se bëhet fjalë për Akt-Ekspertizën e bërë për pallatin ku jetonte L. T., i cili është vlerësuar i pabanueshëm.

Përsa më sipër, nga ana e subjektit ankues nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë dokument me anë të të cilin të provohet fakti që ankuesi disponon një banesë, e cila është prekur nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe është konstatuar si e pabanueshme nga strukturat e Institutit të Ndërtimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si në rastin e L. T.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, si: “*Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Mbështetur edhe në provat e administruara nga palët në proces, Komisioneri konstaton faktin se ankuesi është personi i cili ka aplikuar për përfitimin e pagesës së qirasë si pasojë e fatkeqësisë natyrore të datës 26.11.2019, në të 2 (dy) rastet. Pra, ka paraqitur aplikimin në emër të L. T. dhe në emër të familjes së tij. Gjithashtu, nuk u administruan prova dhe fakte se banesa e ankuesit ishte vlerësuar e pabanueshme nga grupi i ekspertëve të Institutit të Ndërtimit, si në rastin e L. T.

Neni 20, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, siguron mbrojtje të individëve nga diskriminimi në fushën e të mirave e shërbimeve. Neni 20, parashikon shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

.....

b) mundësi për të marrë ose për të përfitur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;

c) kontributin dhe mundësinë për të përfitur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

.....”

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Bashkia Durrës, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Durrës, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi lidhur me mospërfitimin e pagesës së qirasë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 3, pika 1, nenin 7, pika 1, nenin 32, pika 1, germa b) dhe, nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit të H. T., nga ana e Bashkisë Durrës, për shkaqet e pretenduara prej tij.

2. I rekomandohet subjektit ankues të aplikojë dhe të plotësojë dokumentacionin e saktë pranë Bashkisë Durrës për përfitimin e pagesës së qirasë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore të datës 26.11.2019.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Etnia dhe gjendja ekonomike)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)